



Solidarité
sans
frontières

NEUENGASSE 8
3011 BERN
TEL 031 311 07 70
FAX 031 311 07 75
WWW.SOSF.CH

2XJO INICIATIVËS SË PARTISË POPULLORE TË ZVICRËS SI DHE KUNDËRPROPOZIMIT **Jo drejtësi të veçantë kundër të huajve!**

Iniciative për dëbim e Partisë Popullore të Zvicrës (në tekstin në vijim: PPZ) dhe kundërpropozimi i aprovuar parlamentar kërkojnë të arrijnë të njëjtin qëllim: Ato dëshirojnë që trajtimin jo të barabartë ligjor të të huajve ta fuqizojnë në kushtetutë. Kundërgargumentet tona në pika të shkurta:

I Iniciativa e PPZ për dëbim: Fushatë elektorale në kurriz të mërgimtarëve

PPZ ndodhet në luftë permanente elektorale – dhe këtë me dekada zhvillon në kurriz të mërgimtarëve dhe refugjatëve duke investuar miliona. Në luftën elektorale më 2007 ajo përmes kampanjës me pllakate dhe afishe proklamoi iniciativën e saj dëbuese. Që ligji për të huajt në fuqi dëbon me qindra të huaj që kanë ra në konflikt me ligjin, aq i bën asaj sikurse edhe fakti që iniciativa e saj është në kundërshtim me të drejtën e popujve dhe me këtë kjo iniciativë është edhe e pazbatueshme. Nxitja e armiqësisë nga ana e PPZ karshi të huajve nuk njeh kufij: Më 1 gusht për betejën elektorale të 2011 ka prezantuar një paletë të tërë iniciativash

II Kundërpropozimi: Shumica parlamntare i shkon pas PPZ

“Partitë e mesit” bëjnë pazare me PPZ dhe duke aprovuar armiqësinë karshi të huajve duan të marrin pjesën e tyre të kulaçit elektor. Në vend se iniciativën ta shpallin të pavlefshme ose së paku të thonë prerë e qartë jo, ata me kundërpropozimin e kërkuar kanë ndryshuar vetëm formën e iniciativës duke e formuluar në atë mënyrë, që aji të është komfor në raport me të drejtën e popujve – d.m.th.: posaçërisht me marrëveshjen bilaterale për lëvizjen e lirë me BE. Si sheqerkë për të majtët kundërpropozimit iu shtua edhe Neni për integrim. Mirëpo ky le anash komplet aspektin më të rëndësishëm për të prekurit – pjesëmarrjen politike - dhe është jo obligues: zbatimin e tij ia le në rrafshin e vullnetit të lirë të Kantoneve.

III Rezultati: Iniciativa dhe kundërpropozimi janë po e njëjta

Iniciativa apo kundërpropozimi – rezultati në të dyja rastet do të ishte i njëjti: drejtësi tri klasash Për të dënuarit zviceran do të vlejë edhe më tej vetëm ligji penal. Për kriminelët nga bashkësia evropiane konventa e lëvizjes së lirë: at mund të dëbohen vetëm nëse pas një dënimi me burg edhe më pas kryejnë ndonjë vepër të rëndë penale. Të gjithë njerëzit tjerë pavarësisht se nga cila pjesë e botës janë goditen rëndë nga neni i propozuar kushtetues.

Ne në të kundërtën themi:

I Jo drejtësi të posaçme kundër të huajve!

Diskriminimi i të huajve nuk duhet të shkruhet në kushtetutë. Ligji penal duhet të jetë i njëjtë për të gjithë. Pa marrë parasysh zviceran apo të huaj: Veprat penale duhet të gjykohen dhe trajtohen njëjtë! Ne nuk duam drejtësi tri klasash!

II Kush ka lindur këtu – duhet edhe të qëndroj këtu!

Shumica e emigrantëve të kërcënuar për dëbim jetojnë dhe punojnë kohë të gjatë në Zvicër, apo edhe anë të lindur këtu: ata të ashtuquajturit sekondarët janë njerëzit e gjeneratës së dytë këtu. Fakti që nuk posedojnë pasaportë zvicerane nuk i bënë ata njerëz më të mirë apo më të keq se sa zviceranët. Ne jemi të mendimit: Ata që kanë lindur dhe janë rritur këtu, i takojnë shoqërisë sonë!

III Jo dënimit “farefisnor” për anëtarët e familjeve!

Përmes dëbimit të anëtarëve të të dënuarve për vepra penale do të dënohen edhe familjet e tyre: fëmijët dhe bashkëshortja, të cilët nuk posedojnë leje të veçanta qëndrimi, jenë të prekur drejtpërsëdrejti. Ato duhet të lëshojnë Zvicrën bashkë me bashkëshortin e tyre. Edhe në rastin kur duhet të dëbohen të rinjtë e dënuar, prindërit e tyre mund të realizojnë të drejtën e prindërve vetëm nëse largohen na Zvicra bashkë me fëmijët e tyre të dënuar. Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Popullore Krishtere (CVP) Urs Schwaller ka protestuar zëshëm, qysh në vitin 2007 kur PPZ proklamoi iniciativën e saj dëbuese, kundër kësaj far përgjegjësie “farefisnore”. Sot “Partia familjare” e tij mbështet kundërpropozimin. Schwaller, si duket a harruar argumentet e tij. Ne jo!

PËRFUNDIMI: Ne themi 2xJO!

MË SHUMË INFORMAT MUND TE MERRNI NË FAQEN TONË TE KAMPANJES

www.2xnein.ch dhe në www.facebook.com/2xnein

Mbështetni kampanjën tonë!

Na ndihmoni duke vepruar aktivisht!

- > Nënshkruani thirrjen tonë në www.2xnein.ch/aufruf
- > Shkruani një letër të lexuesve
- > Diskutoni me të njohurit tuaj
- > Vizitoni manifestimet dhe shprehni hapur dhe qartë mendimet tuaja!
- > Dërgoni Emal-ë dhe shkresa të njohurve dhe shpjegoni atyre shkurt dhe qartë përse duhet të votojnë 2XJO

Na mbështetni financiarisht. Ndhmoni në:

Solidarité sans frontières 3011 Bern Postcheckkonto PC 30-13574-6	Qëllimi i ndihmës (ju lutmi shënoni): > 2xJO Spende (shuma e lirë) > 2xJO Club200+ (shuma minimale 200.- Fr.)
---	--

Diese Organisationen unterstützen ein 2xNEIN

Stand 14. September 2010

AL Schaffhausen | Amnesty International Schweiz | Asylbrücke Zug | BaStA! | augen auf Zürich | bblackbox | Berner Beratungsstelle für Sans-Papiers | Bleiberecht-Kollektive Schweiz | cfd - die feministische Friedensorganisation | CCSI SOS-Racisme Fribourg | C.E.D.R.I. | CSP- Vaud | Comedia - die Mediengewerkschaft | Demokratische Juristinnen und Juristen Schweiz (DJS-JDS) | Eidgenössische Kommission für Migrationsfragen (EKM) | Eidgenössische Kommission gegen Rassismus (EKR) | Europäisches BürgerInnen Forum / Forum Civique Européen | FIMM (Forum für die Integration der MigrantInnen) | FIZ (Fachstelle Frauenhandel und Frauenmigration) | Freundeskreis Cornelius Koch / Cercle d'amis Cornelius Koch | Grüne Schweiz | Gemeinschaft Christlichen Lebens in der Schweiz (GCL-CH) | Geschäftsleitung SP Schweiz (Parolenantrag) | GfbV Gesellschaft für bedrohte Völker | Gesellschaft Minderheiten Schweiz (GMS) | Interprofessionelle Gewerkschaft der ArbeiterInnen Basel (IGA) | Jesuitenflüchtlingsdienst in der Schweiz (JRS-Schweiz) | Katholische Universitätsgemeinde Basel | Komitee CoCHones | Liste 13 gegen Armut und Ausgrenzung | MLCR Mouvement de lutte contre le racisme | Passe-Partout Basel | Sans-Papiers Anlaufstelle Basel | Schlussresolution der Landhausversammlung | Schweizerischer Friedensrat (SFR) | Schweizerischer Gewerkschaftsbund (SGB-USS) | Solidarité sans frontières | Solinetz Basel | Solinetz Ostschweiz | SPAZ Anlaufstelle für Sans-Papiers Zürich | Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus (GRA) | Verein für eine tolerante und offene Schweiz (tuos) | Unia Migrationskonferenz | vpod Migrationskommission.

Diese Organisationen unterstützen ein 2xNEIN

Stand 14. September 2010

AL Schaffhausen | Amnesty International Schweiz | Asylbrücke Zug | BaStA! | augen auf Zürich | bblackboxx | Berner Beratungsstelle für Sans-Papiers | Bleiberecht-Kollektive Schweiz | cfd - die feministische Friedensorganisation | CCSI SOS-Racisme Fribourg | C.E.D.R.I. | CSP- Vaud | Comedia - die Mediengewerkschaft | Demokratische Juristinnen und Juristen Schweiz (DJS-JDS) | Eidgenössische Kommission für Migrationsfragen (EKM) | Eidgenössische Kommission gegen Rassismus (EKR) | Europäisches BürgerInnen Forum / Forum Civique Européen | FIMM (Forum für die Integration der MigrantInnen) | FIZ (Fachstelle Frauenhandel und Frauenmigration) | Freundeskreis Cornelius Koch / Cercle d'amis Cornelius Koch | Grüne Schweiz | Gemeinschaft Christlichen Lebens in der Schweiz (GCL-CH) | Geschäftsleitung SP Schweiz (Parolenantrag) | GfbV Gesellschaft für bedrohte Völker | Gesellschaft Minderheiten Schweiz (GMS) | Interprofessionelle Gewerkschaft der ArbeiterInnen Basel (IGA) | Jesuitenflüchtlingsdienst in der Schweiz (JRS-Schweiz) | Katholische Universitätsgemeinde Basel | Komitee CoChones | Liste 13 gegen Armut und Ausgrenzung | MLCR Mouvement de lutte contre le racisme | Passe-Partout Basel | Sans-Papiers Anlaufstelle Basel | Schlussresolution der Landhausversammlung | Schweizerischer Friedensrat (SFR) | Schweizerischer Gewerkschaftsbund (SGB-USS) | Solidarité sans frontières | Solinetz Basel | Solinetz Ostschweiz | SPAZ Anlaufstelle für Sans-Papiers Zürich | Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus (GRA) | Verein für eine tolerante und offene Schweiz (tuos) | Unia Migrationskonferenz | vpod Migrationskommission.